



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**

---

Numri i lëndës: 2019:300550  
Datë: 20.10.2020  
Numri i dokumentit: 01203998

**C.nr.13/20**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtari Venhar Salihu, kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët porotë Emrush Qamili dhe Ramadan Salihu, anëtar të trupit, në çështjen juridike të propozuesës H. S–K Komuna e Kamenicës, të cilën me autorizim e përfaqëson I.R avokat nga Gjilani dhe propozuesit A. S. Komuna e Kamenicës, të cilin e sipas autorizimit e përfaqëson Amir Rudaku avokat nga Gjilani, me objekt kontesti, shkurorëzim me marrëveshje, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik me datë: 19.10.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. ZGJIDHET MARTESA** e lidhur më datë 26.12.2019, në Zyrën e Gjendjes Civile në Kamenicë, e regjistruar me numër rendor 143, numër të referencës M 10938785, në mes të propozueses H.S me mbiemër të vajzërisë K e lindur me datë ..., Komuna e Kamenicës, nga babai L. K dhe nëna Xh K, dhe propozuesit A.S, i lindur me datë..., Komuna e Kamenicës nga babai A. S1 dhe nëna M. S.

**II.** Fëmijët e mitur E. S, i lindur medaten... në Gjilan, E. S1, i lindur me datë... në Wels të Austrisë dhe A.S2 e lindur me datë... në Wels të Austrisë, i besohen në ruajtje, kujdes dhe edukim, propozueses H. S si nënë e tyre, kurse sa i përket kontaktit në mes fëmijëve të mitur dhe propozuesit A. S si baba i tyre, mbetet i lirë.

**III.** Obligohet propozuesi A. S që në emër të alimentacionit për fëmijët e mitur E. S të paguaj shumën prej 370€, për E. S1 shumën prej 350€ dhe për A, S2 shumën prej 280€, për çdo muaj, duke filluar nga 19 tetori i vitit 2020, e deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore.

#### IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### Arsyetimi

Propozuesit në këtë gjykatë kanë paraqitur padi për zgjidhjen e martesës, duke theksuar se të njëjtit kanë lidhë martesë me dt. 24.06.2002 dhe kanë tre fëmijë të mitur edhe atë E. S i lindur me daten..., E. S1 I lindur me daten... dhe A. S2 e lindur me dage .... Në fillim të lidhjes ndërgjyqësit kanë jetuar mire, por me lindjen e fëmijëve janë krijuar mosmarrëveshje, mospajtime, moskuptime reciproke, mos interesim për jetë të përbashkët dhe mos respektim I thellë reciprok. Të njëjtit janë përpjekur që bashkësinë martesore ta rregullojnë, por nuk kanë pasur sukses dhe kanë shkëputur bashkësinë faktik edhe jetojnë ndaras në Austri si dhe ne Kosovë. Për këtë arsye kanë paraqitur këtë propozim dhe nga gjykata kanë kërkuar që martesë e tyre të zgjidhet me marrëveshje, kurse sa i përket fëmijëve të njëjtit ti besohen propozueses si nënë<sup>1</sup>.

Sa i përket tentim pajtimit gjykata ka caktuar një seance të veçantë dhe nga përfaqësuesit e palëve është kërkuar që ti njoftojnë propozuesit, por edhe për kundër kësaj të njëjtit nuk kanë prezentuar në seancën e tentim pajtimit të dt.28.09.2020 dhe mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar, kurse të autorizuarit e propozuesve kanë njoftuar gjykatën se palët e tyre janë deklaruar se nuk dëshirojnë që ta vazhdojnë jetën bashkëshortore me njërin tjetrin, por janë përcaktuar që të vazhdojnë jetën pa njëri tjetrin. Gjykata duke u bazuar këtë gjendje në njërën anë, kurse në anën tjetër duke u bazuar në nenin 79.2 të LFK-së, ka konsideruar se séance e tentim pajtimit është e dështuar dhe ka çmuar se nuk ka nevojë për përpjekje të reja që të arrihet pajtimi, pasi që ky është vullneti i propozuasve.

I autorizuari i propozueses në shqyrtimin gjyqësor ka mbetur në tërësi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, marrëveshjes me shkrim sa i përket besimit, ruatjes dhe edukimit të fëmijëve të mitur, kurse sa i përket alimentacionit i njëjti i ka propozuar gjykatës që të caktohet alimentacioni në bazë të marrëveshjes të vetë palëve të arritur në entin pranë komunës së Welsit të shtetit të Austrisë.

I autorizuari i propozuesit në shqyrtimin gjyqësor kambetur në tërësi sikurse i autorizuari i propozueses dhe nga gjykata ka kërkuar që të zgjidhet martesë i propozuesve, kurse sa i përket fëmijëve të mitur dhe alimentacionit të veprohet sipas marrëveshjes të vetë propozueses me propozuesin.

Asnjëri nga përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse nuk i ka kërkuar shpenzimet e kësaj procedure.

Meqë është kërkuar zgjidhja e martesës me propozim të përbashkët, gjykata nuk është lëshuar në verifikimin e fakteve në të cilat mbështetet propozimi për shkurorëzim dhe

<sup>1</sup> Të njëjtën kohe propozuesit gjyktës i kanë paraqitur edhe marrëveshje me shkrim për besim, ruatje dhe edukim të fëmijëve të tyre.

atë duke u bazuar në nenin 84 të LFK-së, por vetëm e ka administruar si provë Çertifikatën e Martesës e dt.26.12.2019 me nr.referencës 10/2002RM/10001: Çertifikatat e lindjes në emër të fëmijëve të mitur E.E.1 dhe A. S.2 ; Marrëveshja me shkrim për besimin ruajtjen dhe edukimin të fëmijëve të mitur si dhe një Shkresën - Marrëveshjen e dt. 08.10.2019.

Edhe për kundër se është kërkuar zgjidhja e martesës me marrëveshje, gjykata duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, duke çmuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku edhe atë sa i përket besimit të fëmijëve dhe alimentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike edhe atë nga çertifikata e martesës, është vërtetuar se propozuesit pranë organit kompetent kanë lidhur martesë me dt. 24.06.2002 dhe nga kjo martesë ka tre fëmijë të përbashkët edhe atë djalin E. S i lindur me daten ... në Gjilan, djalin E. S1 i lindur me daten ...në Wels si dhe vajzën A. S2 e lindur me daten... ne Wels (fakte këto të vërtetuara nga çertifikata e lindjes për fëmijët e mitur). Nga marrëveshja me shkrim për besimin ruajtjen dhe edukimin të fëmijëve të mitur gjykata vërtetoi se palët ndërgjyqëse janë marrë vesh që fëmijët e mitur E. E1 dhe A. S2 që për të njëjtit tutje të kujdeset të ruaj dhe edukoj propozuesja H. S si nënë, kurse sa i përket alimentacionit të njëjtit kanë cekur se e kanë një marrëveshje për ushqimi. Nga marrëveshja e dt.08.10.2019 gjykata vërtetoi faktin se propozuesit janë marrë vesh që propozuesi A. S, propozueses ti paguaj alimentacion për fëmijët si në vijim: E.S shumë prej 370€, për fëmijën E.S1 shumë prej 350€ kurse për vajzën A.S2 shumë prej 280€.

Gjykata në rastin konkret sa i përket zgjidhjes së martesës duke u bazuar në nenin 69.2 të LFK-së erdhi në përfundim se propozimi për zgjidhjen e martesës është i bazuar, pasi që dispozita e lartëcekur si shkaqe për shkurorëzim ka paraparë edhe shkurorëzimin me marrëveshje të dyshme, e në rastin konkret nga të lartëcekurat pa dyshim se propozuesit siç thamë më lartë me marrëveshje kanë kërkuar që martesë e tyre të zgjidhet, dhe për këto arsye u vendos sin ë pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II dhe III të këtij aktgjykimi, që fëmijët e mitur E. E1 dhe A .S2 ti besohen në ruajtje, edukim propozueses H. S si nënë, kurse e obligoi propozuesin A. që për çdo muaj për djalin E. S të paguaj shumë prej 370€, për E. S1 shumë prej 350€ dhe për vajzën A.S2 shumë prej 280€, në emër të alimentacionit edhe atë duke filluar nga dt.19.10.2020 (si date kur është marrë ky aktgjykim) e deri sa për këtë ekzistojnë kushtet ligjore, krejt këto duke u bazuar në marrëveshjen e palëve dhe nenin 70.2 të LFK-së.

Gjykata vendosi sin ë pikën IV të dispozitivit duke u bazuar në nenin 347 të LFK-së lidhur me nenin 450 të LPK-së, pasi që asnjëri nga palët nuk i kërkoi shpenzimet e kësaj procedure

Prandaj, nga gjendja e spjeguar më lartë, duke përfshirë gjendjen faktike, dispozitat ligjore dhe bindjen e lire të gjykatës, në një të anë, kurse në anën tjetër, bazuar në nenet 2 lidhur me 142 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**C.nr.13/20, dt.19.10.2020**

Numri i lëndës: 2019:300550  
Datë: 20.10.2020  
Numri i dokumentit: 01203998

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Venhar SALIHU

**KËSHILLA JURUDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në në Gjykatën e Apelit edhe atë në afatin prej 15 ditësh, duke llogaritur nga dita pas pranimit të të njëtit aktgjykim. Akesa eventual në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.